



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3001/17 prot.

Datë 31.01.2024

V E N D I M

Nr. 120/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.01.2024 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Albania Distribution Chemicals” SHPK me NUIS M11815028I, me adresë: “Rruga e Kavajes”, Buka SH.A, Nr.8240, Njesia Nr.6, Tirane.

- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A me adresë: Rruga “Skënderbeu”, Qafë-Gjashtë, Sarandë,
- Subjekte të Interesuara:** “2 AT” SHPK me NUIS K14019001H, me adresë: Disnicë, Korçë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

- I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.11.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë*”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.

II.2. Në datën 23.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Albania Distribution Chemicals” SHPK 4.600.000 lekë, skualifikuar
2. “2 AT” SHPK 5.440.000 lekë, kualifikuar
3. “Atlantik 3” SHPK nuk ka oferte, skualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit:

Mungojne dokumentet e meposhtme:

1. *Bilanci dhe xhiro vjetore e vitit 2020*
2. *Fleta e analizes se treguesve kimik jashte afatit kohor prej 3 muajve te fundit*
3. *Certifikata e transportit per mallra te rrezikshme.”*

II.4. Në datën 30.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE). Operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit si vijon:

Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals“ ShPK, nuk ka paraqitur dokumentacion te plote per keto pika te kriterave te vecanta te DST-ve;

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% e fondit limit që prokurohet.

O.E. ka paraqitur vertetim per xhiron vjetore te viteve 2021 dhe 2022 dhe nuk ka paraqitur vertetim per xhiron e vitit 2020

2.2.2 Kopje te certifikuara te bilanceve per 3 vitet e fundit (2020, 2021 dhe 2022) te konfirmuara nga autoritetet perkatese. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

O.E. ka paraqitur kopje te certifikuara te bilanceve te viteve 2021 dhe 2022 dhe nuk ka paraqitur kopje te certifikuara per bilancin e vitit 2020

2.3.3 *Operatori Ekonomik duhet te paraqesi fleten e analizes per treguesit si me poshte: Pamja (ngjyra dhe era), Klori aktiv C12, Kadmium (Cd), Krom (Cr), Nikel (Ni), Plumb (Pb) Densiteti, Arseniku (As), Mërkuri (Hg), Antimoni (Sb), Seleni (Se)*

per produktet qe prokurohen (te 3 muajve te fundit), nga nje institucion shteteror si Instituti i Shendetit Publik ose nje institucion tjeter i akredituar ne vend ose jashte vendit.

Dokumenti qe O.E. ka paraqitur “ Raport analize nr.34” me nr.prot. 621/1 ,nga ISHP-ja, mban daten 10.07.2023,pra jashte afateve te vlefshmerise te kerkuara me siper

2.3.5 *Operatori Ekonomik, per automjetin transportues, duhet te paraqese **Certifikate për Transport Mallrash të Rrezikshme**, te leshuar nga DPSHTRR, kur automjeti eshte ne pronesi te tij, dhe kur automjeti eshte marre me qira, pervec certifikates se mesiperme, duhet te paraqese, **Kontrate Qiraje** (ose huaperdorje) me akt-noterial, te vlefshme deri ne perfundim te kontrates.*

O.E. nuk ka paraqitur asnje dokument per te plotesuar kerkesen e mesiperme dhe si rrjedhim nuk i ploteson kushtet per kualifikim.

II.5. Në datën 03.12.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3001/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3664, e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë*”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK. Konkretisht operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK pretendon si vijon:

“2.2.2 Kopje te certifikuara te bilanceve per 3 vitet e fundit (2020, 2021 dhe 2022) te konfirmuara nga autoritetet perkatese. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Per skualifikimin qe AK ka bere ne lidhje me kete kriter, kompania Albania Distribution Chemicals eshte themeluar ne daten 14.06.2021 dhe per kete fakt nuk mund te paraqesim xhiron dhe bilancet e viteve 2020 sepse kompania jone nuk ka ekzistuar.

Ne permbushje te kriterave per kapacitetin ekonomik si garanci financiare ne fazen e dorezimit te ofertave ne ju veme ne dispozicion Bilancin e vitit 2021 dhe 2022 per te vertetuar kapacitetin tone financiar per te realizuar me sukses kete prokurim publik gjate periudhës 14.06.2021 deri ne 31.12.2021.

Mungesa e xhiros vjetore për vitin 2020 nuk mund të konsiderohet shkak për skualifikimin e këtij operatori ekonomik, pasi në secilën prej dy viteve të tjera, xhiroja vjetore e shoqërisë ka qenë disa herë më e madhe se kërkesa e autoritetit kontraktor që: “vlera mesatare e xhiros në

të paktën njërin prej tre viteve të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të këtij prokurimi”. Pra, që të quhej i përmbushur kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK duhet të plotësojë kërkesën e autoritetit kontraktor për të paktën një vit nga tre vitet e fundit, ndërkohë që operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK e përmbush dhe e tejkalon kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor pika 2.2.2 “kapaciteti ekonomik dhe financiarë, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi vlera e xhiros për vitin 2021 është 22.165.842 dhe për vitin 2022 është 69.792.037 lekë, pra shumë herë më e madhe se 40% e fondit limit prej 5 600 000 lekë.

[...]

Ishte :

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fletën e analizës për treguesit si me poshtë:

Pamja (ngjyra dhe era), Klori aktiv Cl₂, Kadmium (Cd), Krom (Cr), Nikel (Ni), Plumb (Pb) Densiteti, Arseniku (As), mërkuri (Hg), Antimoni (Sb), Seleni (Se) për produktet që prokurohen (të 3 muajve të fundit), nga një institucion shtetëror si Instituti i Shëndetit Publik ose një institucion tjetër i akredituar në vend ose jashtë vendit.

Behet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fletën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik për analizat si me poshtë:

Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd), Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti

Ose

Analizimi i metaleve të rënda të kimikateve të behet në një laborator të licensuar (vendas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizojë metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e siperpermendura.(Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik). Në kërkesën për sqarim që i kemi dërguar AK (gjeni bashkangjitur) i kemi vënë këtij AK vendimin në lidhje për afatin kohor të Analizës së ISHP-se, vendimin që ju si KPP keni nxjerr me Nr Vendimi 473/2023, Date 06.06.2023.

Në shtojcën e nxjerr nga AK në datën 14.11.2023, ka ndryshuar këto kriter:

Behet :

Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fletën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik për analizat si me poshtë:

Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd), Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti

Ose

Analizimi i metaleve të rënda të kimikateve të behet në një laborator të licensuar (vëndas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizojë metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e siperpermendura. (Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik).

Për këto arsye në si Operator Ekonomik kemi vendosur në sistem flet analizën (gjeni bashkangjitur). Gjithashtu ju si KPP, me Nr Vendimi 473/2023, Date 06.06.2023, të cituar me sipër keni nxjerrë një vendim në lidhje me këto kriter. AK e ka pranuar duke e ndryshuar, dhe në momentin e vlerësimit na skualifikon me arsyen se :

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqesë fletën e analizës për treguesit si me poshtë : Pamja (ngjyra dhe era), Klori aktiv C12, Kadmium (Cd), Krom (Cr), Nikel (Ni), Plumb (Pb) Densiteti, Arseniku (As), mërkuri (Hg), Antimoni (Sb), Seleni (Se) për produktet që prokurohen (te 3 muajve të fundit), nga një institucion shtetëror si Instituti i Shëndetit Publik ose një institucion tjetër i akredituar në vend ose jashtë vendit.

Dokumenti që O.E. ka paraqitur Raport analize nr.34 me nr.prot. 621/1 , nga ISHP-ja, mban datën 10.07.2023, pra jashtë afatëve të vlefshmerisë të kërkuara me sipër.

Duam të besojmë se skualifikimi në lidhje me këto arsye është një gabim njerzor duke mos parë shtojcën e nxjerrje po nga AK.

2.3.5 Operatori Ekonomik, për automjetin transportues, duhet të paraqesë Certifikatë për Transport Mallrash të Rrezikshme, të leshuar nga DPSHTRR , kur automjeti është në pronësi të tij, dhe kur automjeti është marrë me qira, përveç certifikatës së mësipërme, duhet të paraqesë, Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme deri në perfundim të kontratës.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas percaktimit në Nenin 82, të LPP-së, dhe në keto rregulla. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Kriteri i kualifikimit mbi disponimin e punonjësve dhe mjeteve/makinerve duhet të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik sipas shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit në respektim të nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të VKM, duke përmbushur kriterin kualifikues mbi disponimin e punonjësve dhe mjeteve/makinerve për këtë fazë, ku autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas percaktimit në Nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, në plotësimin e këtyre kriteve të vecanta të kualifikimit të sipërcituara, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE):

Deklaratën (gjeni bashkangjitur) duke deklaruar :

Automjetin me Qera: AA273LC Nr Shasise ZCFC35C1005521836

Kontratë Huapërdorimi : Nr Repertori: 2320, Nr Koleksioni :1366, Tirane 21.05.2022 [...].

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3001/2 prot., datë 04.12.2023, me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

II.7. Në datën 05.12.2023, ka ardhur në sistem Formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 3001/3 prot., datë 05.12.2023. Gjithashtu, edhe në datën 07.12.2023, është protokolluar në KPP me nr. 3001/4, formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK, janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, referuar nenit 113, ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

II.8. Me anë të shkresave me Nr. 665 prot., datë 07.12.2023 dhe me nr. 2/1 prot., datë 05.01.2024, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 3001/6 prot., datë 11.12.2023 dhe me nr. 3001/8 prot., datë 08.01.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit më datë 07.12.2023, të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, sipas së cilës është vendosur pranim i pjesshëm të ankesës.

II.9. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimin nr. 3 të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, si më poshtë:

“Lidhur me pikën 2.3.3, pretendimi i OE qëndron, pasi sipas shtojcës për disa ndryshime në DST me nr.REF- 86642-11-07-2023 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Ahoqërisë Rajonale UK Sarandë”, me fond limit 5.600.000 lekë pa TVSH, bazuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimet Publike”, Neni 75, autoriteti kontraktor ka bërë ndryshime në DST”.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 3001/9 prot., datë 16.01.2024, me objekt “Kërkesë për informacion”, bazuar në nenin 113 dhe 114, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion si më poshtë:

- 1. A e keni njoftuar operatorin ekonomik “2 AT” SHPK mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK? Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.*
- 2. Nëse nuk e keni njoftuar operatorin ekonomik “2 AT” SHPK, të merren masa për njoftimin e tij mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, si dhe të dërgohet kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.*

II.11. Me shkresën me nr. 53/1 prot., datë 19.01.2024, me objekt: “Vënie në dijeni lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”, protokolluar në KPP me nr. 3001/10 prot., datë 22.01.2024, autoriteti kontraktor informon këtë Komision si vijon: “Në vijim të shkresës Tuaj me nr. 3001/9 prot., datë 16.01.2024, bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën drejtuar Shoqërisë “2 AT” SHPK,

për vënien në dijeni lidhur me ankesën e paraqitur nga OE “Albania Distribution Chemicals” SHPK dhe vendimin e marrë nga Komisioni për shqyrtimin e ankesës”, bashkëlidhur shkresa nr.53/2 prot., datë 19.01.2024, me objekt: “Vënie në dijeni”, drejtuar shoqërisë “2 AT” SHPK, me anë të së cilës ky i fundit vihet në dijeni të vendimit të KSHA-së, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

II.12. Njëpërmjet shkresës nr. 3001/11 prot., datë 23.01.2024, me objekt “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor, brenda ditës së nesërme nga marrja e kësaj shkrese, të sjellë pranë KPP-së dokumentacionin provues për datën e marrjes dijeni të operatorit ekonomik “2 AT” SHPK, për sa i përket vendimit të KSHA-së për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Gjithashtu, njëpërmjet shkresës nr. 3001/12 prot., datë 23.01.2024, me objekt “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion shoqërisë “2 AT” SHPK, si subjekt i interesuar në këtë procedurë prokurimi, nëse është njoftuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me vendimin e KSHA-së për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nëse po, iu kërkua të paraqesë në KPP të dokumentuara, të gjitha provat dhe faktet në lidhje me momentin e marrjes dijeni të këtij njoftimi, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja dijeni e kësaj shkrese.

II.13. Në datën 29.01.2024 është protokolluar në KPP me nr. 3001/13 prot., shkresa e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK, me objekt: “*Kthim përgjigje shkresës nr. 3001/12, datë 23.01.2024*”, me anë të së cilës informohet Komisioni i Prokurimit Publik si vijon: “[...] *Bazuar në shkresën e dërguar nga KPP nr. 3001/12 prot., datë 23.01.2024, dorëzuar nga Posta në ambientet e firmës “2AT” SHPK, datë 26.01.2024, ora 15.30, ju informojmë se jemi njoftuar nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë SH.A me shkresën nr. 53/2 prot., datë 19.01.2024, dorëzuar në ambientet e firmës “2 AT” SHPK datë 23.01.2024 ku jepet shqyrtimi i dokumentacionit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dt. 21.11.2023.*”

II.14. Në datën 29.01.2024, është protokolluar në KPP me nr. 3001/14E prot., shkresa e autoritetit kontraktor “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë SH.A”, me objekt: “*Kthim - përgjigje*”, me anë të së cilës bëhet me dije Komisioni i Prokurimit Publik si vijon: “[...] *Shkresa me nr. 53/2 prot., datë 19.01.2024, drejtuar shoqërisë “2 AT” SHPK, është dorëzuar nga ana jonë në postë më datë 19.01.2024 dhe është marrë nga shoqëria “2 AT” SHPK, më datë 24.01.2024, referuar gjurmimit të objekteve.*”

II.15. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se janë paraqitur argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK, por ai nuk ka ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti kontraktor mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115, pika 2 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se: “*Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga*

operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1, të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar dhe do të vazhdojë shqyrtimin për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, skualifikimin e tij të padrejtë nga ana e KVO-së, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me anë të shkresave me Nr.665 prot., datë 07.12.2023 dhe me nr. 2/1 prot., datë 05.01.2024, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 3001/6 prot., datë 11.12.2023 dhe me nr. 3001/8 prot., datë 08.01.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit më datë 07.12.2023, të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, sipas së cilës është vendosur pranim i pjesshëm të ankesës.

III.1.2. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimin nr. 3 të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, si më poshtë:

“Lidhur me pikën 2.3.3 pretendimi i OE qëndron, pasi sipas shtojcës për disa ndryshime në DST me nr.REF- 86642-11-07-2023, me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”, me fond limit 5.600.000 lekë pa TVSH, bazuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimet Publike”, Neni 75, autoriteti kontraktor ka bërë ndryshime në DST”.

III.1.3. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, përse kohë që operatori ekonomik “2 AT” SHPK nuk ka ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti kontraktor mbi trajtimin e ankesës së ankimuesit.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës .

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, se: “Mungojne dokumentat e meposhtme:1. Bilanci dhe xhiro vjetore e vitit 2020”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7, pika 2.2.1 dhe 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve për 3 vitet e fundit (2020, 2021 dhe 2022) të konfirmuara nga autoritetet perkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi, se në funksion të plotësimit të kriterit 2.2.1 të mësipërm, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK ka dorëzuar vërtetimin Nr. T09410622, datë 16.11.2023, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë, me përmbajtje si më poshtë:

Nr.	Periudha tatimore	Shuma
1	22-A	69.792.037
2	21-A	22.165.842

Ky vërtetim lëshohet për pjesëmarrjen në tenderin që zhvillohet në datën 2023.11.21, sipas ftesës së bërë nga enti prokurues (institucioni): Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande SH.A, me objekt prokurimi: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kerkesat e Shoqerise Rajonale UK Sarande”, me vlerë: 5600000 lekë, me vendndodhje në Sarande.

Ndërsa për plotësimin e kriterit 2.2.2 si më sipër cituar, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK ka paraqitur në SPE dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Pasqyrat Financiare viti 2020, të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK., të konfirmuara nga autoritetit përkatës.
2. Pasqyrat Financiare viti 2021, të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.5. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...].

Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Vërtetim nr. T09410622, datë 16.11.2023, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë, në të cilin pasqyrohet xhiroja e dy viteve, 2021, 2022, të subjektit “Albania Distribution Chemicals” SHPK. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur pasqyrat financiare për vitet 2021 dhe 2022, për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor parashikuar në pikën 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit si më sipër cituar. Referuar ekstraktit të regjistrimit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton, se operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK është regjistruar si shoqëri tregtare në datën 15.06.2021 dhe dokumentacioni që ka paraqitur i përket respektivisht viteve 2021 dhe 2022. Në këto kushte, mungesa e xhiros vjetore për vitin 2020 dhe e pasqyrave financiare për vitin 2020 nuk mund të konsiderohet shkak për skualifikimin e këtij operatori ekonomik.

Gjithashtu, rezulton, se në secilën prej dy viteve të tjera, 2021 dhe 2022, xhiroja vjetore e shoqërise ka qenë disa herë më e madhe se kërkesa e autoritetit kontraktor që: “*vlera mesatare e xhiros në të paktën njërin prej tre viteve të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të këtij prokurimi*”. Që të quhej i përmbushur kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor për xhiron, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK duhet të plotësonte kërkesën e autoritetit kontraktor për të paktën një vit nga tre vitet e fundit, ndërkohë që operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK e përmbush dhe e tejkalon kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi vlera e xhiros për vitin 2021 është 22.165.842 dhe për vitin 2022 është 69.792.037 lekë, pra shumë herë më e madhe se 40% e fondit limit prej 5 600 000 lekë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK qëndrojnë.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, se: “*Mungojne dokumentat e meposhtme: 3. Certifikata e transportit per mallra te rrezikshme*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
---------------------	------------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
<input type="checkbox"/> ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
<input type="checkbox"/> kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
<input type="checkbox"/>	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>

<p>Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	
--	--

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	
<p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;</p>	<p>Po []</p>
<p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>	<p>Po []</p>
<p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet</p>	<p>Po []</p>

<p><i>si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</i></p> <p><i>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</i></p> <p><i>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</i></p>	
<p><i>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</i></p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p><i>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</i></p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p><i>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</i></p> <p><i>a) çmimet;</i></p> <p><i>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</i></p> <p><i>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</i></p>	<p>Po [] Jo []</p>

d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe</p>

territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit
A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ <u>Profili i punonjësve</u> _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Data e dorëzimit të deklaratës _____ Emri, Mbiemri, Firma _____	Vula _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë

elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.3.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi , nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5 Operatori Ekonomik, per automjetin transportues, duhet te paraqese *Certifikate për Transport Mallrash të Rrezikshme*, te leshuar nga DPSHTRR, kur automjeti eshte ne pronesi te tij, dhe kur automjeti eshte marre me qira, pervec certifikates se mesiperme, duhet te paraqese, **Kontrate Qiraje (ose huaperdorje) me akt-noterial, te vlefshme deri ne perfundim te kontrates.**

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ku në Deklaratën B për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme është plotësuar si vijon: “me të dhënat konkrete: Me qira: AA273LC; Nr. Shasisë ZCFC35C1005521836 Kontratë Huaperdorimi: Nr. Repertori: 2320, Nr. Koleksioni:1366, Tiranë 21.05.2022.

III.3.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.3.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.3.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.3.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.3.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti

ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.3.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për disponimin e automjetit transportues, për të cilin ofertuesi duhet të paraqesë *Certifikate për Transport Mallrash të Rrezikshme, të lëshuar nga DPSHTRR, kur automjeti është në pronësi të tij, dhe kur automjeti është marrë me qira, përveç certifikates së mesiperme, duhet të paraqesë, Kontrate Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme deri në përfundim të kontratës, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar në sistemin e*

prokurimit elektronik (SPE) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8), në të cilit ka deklaruar se disponon mjetin me targë AA273LC; Nr. Shasie ZCFC35C1005521836 me Kontratë Huapërdorimi me Nr. Repertori:2320; Nr. Koleksioni:1366 dhe datë 21.05.2022.

Në “Njoftimin e fituesit” të publikuar në SPE në datën 30.11.2023, rezulton se Autoriteti kontraktor ka skualifikuar këtë operator ekonomik me arsyetimin se *nuk ka paraqitur asnjë dokument per te plotesuar kerkesen për automjetin transportues*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar targën dhe nr. e shasisë së mjetit, si dhe të dhënat e kontratës me huapërdorim. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftimit-fituesit, nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Gjithashtu, nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t’i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor “Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A”, nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronjën i) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti, për arritjen e një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimues nuk e plotëson këtë kriter.*

Gjithashtu, sipas shtojcës 12, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklaratah do të bëhen *në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”*. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund t’i marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilin ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesës për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend

të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti, pasi nga shqyrtimi dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të këtë bërë një hetim apo verifikim për mjetet. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata, dhe më pas të marrë vendim lidhur me to.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285,** si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit, është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

